



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:034569
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758418

C.nr.326/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit V.M. nga Komuna e D., të cilin e përfaqëson F.B. avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, në seancën e datës 24.05.2024 mori ndërsa me datën 30.05.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit V.M. nga Komuna e D., e parashtruar me datë 05.03.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar av. F.B., me datë 05.03.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

Gjykata, me datën 24.05.2024, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën nuk kanë prezantuar paditësi, përkatësisht përfaqësuesi i tij, i autorizuar av. F.B., edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar dhe po ashtu nuk ka prezantuar as pala e paditur e cila ishte e ftuar në mënyrë të rregullt.

Sipas nenit 423 par.3 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.”*. Prandaj në referim të kësaj dispozite

ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 423 par.3, 142 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.326/20, me datë 30.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.